

AKT – THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
" CLAUDIO 2009" SHPK

Sot me daten 20/04/2023 (dymijë e njëzet e tre), ne ortaket themelues :

- **1 Z. Giancarlo Bocchese**, shtetas Italian, i datëlindjes 14 Gusht 1967, lindur në Chiampo,Itali dhe banues në Itali, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues I Leternjoftimit (kartë identiteti) me Nr. YC0065642
- **2 Z. Klodian Qoshja**,shtetas shqiptar , i datëlindjes 02 Mars 1977, lindur në Durrës, dhe banuese në Durrës, disponues i letërnjoftimit (kartë identiteti), me Nr. H70302066I

Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ",

Kam vendosur të themeloj Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar " CLAUDIO 2009" SHPK.

NENI 1.
EMËRTIMI I SHOQËRISË

Shoqëria do të quhet " CLAUDIO 2009" SHPK.

NENI 2
SELIA E SHOQËRISË

Shoqëria do të ketë selinë e saj në, DURRES, Lagjja nr 11, Rruga "Aleksander Goga",Zona kadastrale 8514, Godina me nr pasurie 1/279,Kati dyte.

NENI 3
OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj ne fushen e : Komisioner për tregtimin e artikujve të ndryshëm industriale, import,export, tregti me shumicë dhe me pakicë të mermerit,granitit dhe të gjithë produkteve dhe nënprodukteve të tyre,shit-blerje artikujsh të ndryshëm,shit-blerje pronash,import-export dhe tregti të lëkurave të ndryshme për punim,etj.

NENI 4
KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË



Kapitali themeltar i shoqërisë "**CLAUDIO 2009**" SHPK është 100.000 (njëqind mijë) lekë. Ky kapital është i ndarë në 2 kuota, me vlerë nominale 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

Kontributi i ortakeve është i ndare si vijon:

1. GIANCARLO BOCCHESI, zotëron 1 kuotë baraz me 50 % të kapitalit.

2. KLODIAN QOSHJA zotëron 1 kuotë baraz me 50 % të kapitalit.

NENI 5

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohe të pacaktuar.

NENI 6

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Administratori i shoqërisë do të jetë **Z. KLODIAN QOSHJA** e cila emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqesojnë me tepër se gjysmen e pjesëve të kapitalit themeltar.

Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë.

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

NENI 7

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Per Shoqëritë Tregtare".

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.


NENI 8

NDARJA E FITIMEVE

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar, të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën, si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.

Neni 9

LIKUIDIMI



Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj , operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregtar shqipëtar.

NENI 10

MOSMARRËVESHJET

Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim. Në rast të kundërt, ortakët themelues do ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Durrës për zgjidhje.

**ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË
"CLAUDIO 2009" SH.P.K
GIANCARLO BOCCHESI KLODIAN QOSHJA**

BOCCHESI
GIANCARLO



KLODIAN QOSHJA

